LUSHNËS NËDERSA SIP. KATI I PARË QË ESHTE NE PËRDORIM
NGA SPITALI I LUSHNËS = 587.9 M²

SHK 1:1000

NR.	PERDORIMI	ORIENTIMI	TIPI I KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1	VERI	HARTE KADASTRALE	PAS-NR 24/112			
2	JUG	HARTE KADASTRALE	PAS-NR 24/112			
3	LINDJE	HARTE KADASTRALE	PAS-NR 24/112			
4	PERENDIM	HARTE KADASTRALE	PAS-NR 24/112			

REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT

Emri: Ing. Arlina Titini
Kompania: Sita Partners Sh.p.k.
Nipt: L42027005K
Licenca: T.1574
DATE: 29.08.2025

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: T (Terren)

Kodet per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Matje Distancash

PERCAKTIMI KUFIRIT: P (Terren me Perfaqesues te Spitalit)

Kodet per percaktimin e kufirit: P-Perfaqesues i Pronareve; K-Kufitaret te Gjithe; KP-Kufitaret Pjeserisht; PB-Perfaqesues Bashkie; HK- Harta Kadastrale

SHENIME TE VEÇANTA:

PASURIA NR. 24/160 NUK ESHTE NE PËRDORIM 100% TË SPITALIT LUSHNJË PASI NJË PJESE TË SAJ ESHTE NE PËRDORIM NGA BASHKIA LUSHNJË. GODINA ESHTE 2 KATE ME SIPERFAQE NE PËRDORIM NGA SPITALI I LUSHNËS SI ME POSHTË:

KATI I PARË: 587.9 M² NËSI

PJESA TJETER E SIPERFAQES NUK ESHTE NE PËRDORIM NGA SPITALI I LUSHNËS.

TRUALLI DO TË JETË I PËRBASHKET

NË HARTËN KADASTRALE ESHTE PASOYRUAR GJENDJA FAKTIKE E PASURIVE.

PRONARI BASHKËPRONARET DEKLARIM MBË MARDHENIET ME KUFITARET

EMRI: **ROKANA ZULU**

NENSHIKRIMI

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi i kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Matje Distancash; P-Perfaqesues i Pronareve; K-Kufitaret te Gjithe; KP-Kufitaret Pjeserisht; PB-Perfaqesues Bashkie; HK- Harta Kadastrale



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE						
PRONARI: SHTET		DATE 21/07/2025		QELIMI: INVENTARIZIM/REGJISTRIM		
VENDNDODHJA: LUSHNJE		DNASHK/ZVASHK	LUSHNJE	ZONA KADASTRALE	8571	NUMRI I PASURISE 24/96
BASHKIA: LUSHNJE		INDEKS HARTE LU-M-08				
TE DHENAT E PASURISE		SIP. PASURISE 52m ²		SIPERFAQE GJURMES SE NDERTIMIT 52m ²		NUMRI KATEVE KT
LLOJI I PASURISE: TRUALL						NUMRI PEMEVE
E(x)= 475697.634		KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE		E(x)= 475792.707		
N(y)=4533406.774				N(y)=4533406.774		
SHPIEGUESE						
Siperfaqja dhe konfiguracioni i pasurise nr.24/96, e cila rezulton te jete e shembur ne terren (e rrenuar)						
KUFIRI I PARCELES NDERTIMORE SIPAS MATJEVE FAKTIKE						
E(x)= 475697.634		SHK 1:500			E(x)= 475792.707	
N(y)=4533337.443					N(y)=4533337.443	
SH.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPIT I KUFIRIT	KUFTETARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1						
2						
3						
4						
5						
REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT						
Emri: Ing. Arlina Titini						
Kompania: "SITA PARTNERS" SHPK						
Nipt: L42027005K						
Licensa: T.1574						
DATE 29.08.2025						
Arlina Titini						
Digitally signed by Arlina Titini Date: 2025.08.29 15:17:54 +02'00'						
TEKNOLOGJIA E MATJEVE: T						
Kodet per teknologjine e matjeve: T-Teren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash						
PERCAKTIMI KUFIRIT: P						
Kodet per percaktimin e kufirit: P-Perfaqesues i Pronareve; K-Kufitaret te Gjithe; KP-Kufitaret Pjeserisht;						
PB-Perfaqesues Bashkie; HK- Harta Kadastrale						
SHENIME TE VEÇANTA: OBJEKTI ESHTE I RRENUAR						
KONFIRMOI						
Pergjegjesi/Drejtori						
Nenshkrimi/Vula						
PRONAR/BASHKIA PRONARE/DEKLARIM MBI MARDHENIET ME KUFITARET						
Emri						
Nenshkrimi						
Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi i kufirit : T-Teren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Perfaqesues i Pronareve; K-Kufitaret te Gjithe; KP-Kufitaret Pjeserisht; PB-Perfaqesues Bashkie; HK- Harta Kadastrale						



VENDIM

Nr. 490, datë 10.9.2025

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË
DETYRË TË DREJTORIT TË
PËRGJITHSHËM TË AGJENCISË
SHTETËRORE PËR SHPRONËSIMIN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të kreut III, të vendimit nr. 395, datë 13.5.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Kastriot Gurra, drejtor i përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin, lirohet nga kjo detyrë.

2. Z. Ermal Shena emërohet drejtor i përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

VENDIM

Nr. 491, datë 10.9.2025

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTIT
“REHABILITIMI I QENDRËS
KINOSTUDIO”, BASHKIA TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i Qendrës Kinostudio”, Bashkia Tiranë.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall”, “ndërtesë”, “apartament” dhe “njësi”, me një vlerë të përgjithshme prej 135 729 849 (njëqind e tridhjetë e pesë milionë e shtatëqind e njëzet e nëntë mijë e tetëqind e dyzet e nëntë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 135 729 849 (njëqind e tridhjetë e pesë milionë e shtatëqind e njëzet e nëntë mijë e tetëqind e dyzet e nëntë) lekësh përballohet nga Bashkia Tiranë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Tiranë.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Tiranë.

8. Në momentin e ekzekutimit të procedurave për likuidim, për çdo pasuri, objekt shpronësimi, që miratohet me anë të këtij vendimi, do të kërkohet dokumentacioni pronësie i rifreskuar për secilin pronar, i konfirmuar nga institucioni kompetent, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, me qëllim verifikimin e kufizimeve përkatëse që mbartin kartelat e pasurive, në bazë të të cilave do të vlerësohet dhe do të bëhet procedura e ekzekutimit të këtij vendimi.

9. Bashkia Tiranë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

10. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Tiranë.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri dhe Drejtoria Vendore Tiranë



Jug, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistrimin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Tiranë për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

12. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Tiranë për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

13. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Tiranë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri e Drejtoria Vendore Tiranë Jug, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

LISTA EMËRORE PËRFUNDIMTARE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME,
PRONË PRIVATE E TË CILËVE SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, PËR
REALIZIMIN E PROJEKTIT “REHABILITIM I QENDRËS KINOSTUDIO”, TIRANË

No.	PRONARI			TË DHËNAT KADAISTRALE (SI PAS KARTELËS SË PASURISË)													VLERËSIMET PËR SHIPRËSIMET					VLERA TOTALE (tëq)	SH. NIM. E (baza line bipast ekuar bazel mbil pasurit e tij)
	EMËR	ATËSIA	MBIEMËR	QYTETI	ZONA, KADAST. RALE	NR. I PASU. RISE	LLOJI I PASURISË	SH. TO TAL. E (m ²)	TR. TAL. L. (m ²)	NDRËT. TESHË (m ²)	VO. LU. M	F. A. Q. E	SIPËRFA QJA (m ²)	ÇMIMI (tëq/m ²)	VLERA (tëq)	SIPËRFA QJA (m ²)	ÇMIMI (tëq/m ²)	VLERA (tëq)	SIPËRFA QJA (m ²)	ÇMIMI (tëq/m ²)	VLERA (tëq)		
1	PERIZ SARA XIHVAZAR E	DIRAN	ÇAKMASHIRI	TIRANË	8120	6/797	TRUALL	642	642	0.00	47	16	9	26.60	29,106.00	774,219.60						774,219.60	
2	ALIGERT	FLAMUR	HYSA	TIRANË	8120	5/247	TRUALL	270	270	0.00	14	95		270.00	29,106.00	7,858,625.00						7,858,625.00	
3	ENGBELLAS		DURBO	TIRANË	8120	5/111	TRUALL	52.50	52.50	0	41	20	7	52.50	29,106.00	1,524,863.54						1,524,863.54	
4	BRUKËNA BRUNILIDAS UZANA	ISMAIL	LALA LALA LALA	TIRANË	8120	5/111-ND	NDËRT. ESË	50	0	50	41	86				50.00				409,192.37	409,192.37		
5	ABRËN LEONARD	MËHIA RREM MËHIA RREM	MEÇO MEÇO	TIRANË	8120	5/255	TRUALL	500	500	107.70	15	16	2	46.00	29,106.00	1,338,876.00						1,338,876.00	
6	R.P. TRASHIGJIM HYSES TARIET E REZA			TIRANË	8120	5/261	TRUALL	137.0	137.0	0	26	17		137.01	29,106.00	3,987,813.06						3,987,813.06	
7	PETRIT	ISMET	SPAHIBU	TIRANË	8120	5/260	TRUALL	143	143	0	26	16		143.00	29,106.00	4,162,158.00						4,162,158.00	
8	BEHDRI PATRASHI A. IBRAHIM LLEJHI SHPEZAI		TURKU AGALLU TURKU DORIBEM TURKU	TIRANË	8120	5/129	TRUALL	492.8	498.2	0.00	18	78	3.00	29,106.00	87,318.00							87,318.00	
9	FERIDANAN D	SIMON	LLËSH	TIRANË	8120	5/076	TRUALL	666.7	666.7	116.9	53	24	6	61.40	29,106.00	1,787,108.00						1,787,108.40	
10	FERIDANAN D	SIMON	LLËSH	TIRANË	8120	5/094	TRUALL	351	351	0	58	20	6	136.20	29,106.00	4,022,449.20						4,022,449.20	
11	FERIDANAN D	SIMON	LLËSH	TIRANË	8120	5/096	TRUALL	1140	1140	30.00	58	23	8	188.80	29,106.00	5,495,212.80						5,495,212.80	
12	MBRASHI	JAKUP	TOPI	TIRANË	8120	6/331	TRUALL	93.01	93.01	0.00	15	24	3	25.30	29,106.00	678,109.80						678,109.80	
13	ENVER		DUKA	TIRANË	8120	5/251	TRUALL	220.0	220.0	0.00	13	21	1	220.01	29,106.00	6,403,611.06						6,403,611.06	
14	EDUARD	SELM	GJETI	TIRANË	8120	5/087	TRUALL	809	809	188.20	57	71	34.20	29,106.00	1,577,545.20							1,577,545.20	
15	ROBERT	KUTJI M	BANO	TIRANË	8120	5/301	TRUALL	706.1	706.1	430.00	20	32	30.30	29,106.00	1,027,441.80							1,027,441.80	
16	ROBERT	KUTJI M	BANO	TIRANË	8120	5/300	TRUALL	150	150	0.00	20	31	22.70	29,106.00	660,786.20							660,786.20	
17	SHIQERIA KASTRATI SHPK			TIRANË	8120	5/164	TRUALL	1170	1170	85	15	18	9	218.80	29,106.00	6,368,392.80						6,368,392.80	
18	HALIT	ADEM	HYSA	TIRANË	8120	5/248	TRUALL	179.8	179.8	0	14	96	179.70	29,106.00	5,258,548.20							5,258,548.20	
19	ANDI KONSTRUKSION			TIRANË	8120	5/110-ND	NDËRT. ESË	0	0	50	20	74				50.00				1,631,011.30	1,631,011.30		
20	MEHAMIT	AQIF	LALA	TIRANË	8120	6/445	TRUALL	264	264	101.50	18	15	0	2.00	29,106.00	38,212.00						38,212.00	
21	MEHAMIT ARTAN IBRAHIM SANDRIT AGIM DASHAMIR QEFSERI IYONSHI ANNA KUTFON ILIR	QAMIL NAIM NAIM HANA N SANDRIT QAMIL IZET QAMIL IBRAHIM KAMIL O IZET	DUKA D																				



	NAZMI PRANVER SAMI VILMA ZEQINE		SHIHAKU MANÇJA KORÇINGOZI KORÇINGOZI KORÇINGOZI																		
28	ADRIAN AGIM ANELA ARTAN BAHRI BESNIK DQORRETE EDHART FATMIR GENÇ HALIL HANKE HYSEN INA JAKUP MIMOZA NADME NAZMI PRANVER SAMI VILMA ZEQINE		NAZMI KORÇINGOZI	TRIANË	8170	3/731	TRUALL	309	309	0	3	15 1	66.30	32,878.00	2,179,811.40					2,179,811.40	
30	LLAMBRINI LLAZAR	KOLJ KREST AQ	BEHROTI KOLJAN	TRIANË	8170	3/95	TRUALL	438.4 3	438.4 3	189	16	91	74.56	32,878.00	2,431,303.68	349.50	97.1 84.2 1	33,963,801.40	69.00	1,626,673.00	38,043,940.08
31	ENGJELLUS HEKUR	ALI GREG OR GREG OR	LOLI LOJ LOJ	TRIANË	8170	3/97	TRUALL	225	225	0	8	11 9	51.00	32,878.00	1,676,778.00					1,676,778.00	
32	ZEF	PJETE B	BALA	TRIANË	8170	3/430	TRUALL	300	300	152.60	8	21 1	182.20	32,878.00	5,990,371.60					5,990,371.60	
33	ENGJELL		MAZREKU	TRIANË	8170	3/137	TRUALL	499	499	205.00	16	11 9	42.60	32,878.00	1,400,602.80					1,400,602.80	
34	ARDHAN AGIM ALDO ANELA ARTAN BAHRI BESNIK DQORRETE EDHART FATMIR GENÇ HALIL HANKE HYSEN INA JAKUP MIMOZA NADME NAZMI PRANVER SAMI VILMA ZEQINE		NAZMI KORÇINGOZI	TRIANË	8170	3/1118	TRUALL	4720.9	4720.9	0	35	20 1	320.8	32878	10,547,262.40					10,547,262.40	
35	ARDHAN AGIM ALDO ANELA ARTAN BAHRI BESNIK DQORRETE EDHART FATMIR GENÇ HALIL HANKE HYSEN INA JAKUP MIMOZA NADME NAZMI PRANVER SAMI VILMA ZEQINE		NAZMI KORÇINGOZI	TRIANË	8170	3/1089	TRUALL	1612	1612	0	35	21 1	5.3	32878	174,253.40					174,253.40	
36	ARBEN KUTIM QAMIL	QAMIL	LALA LALA	TRIANË	8170	3/1119-NA	NDËRT ESE	27.3	0	27.3	35	22 8	0	0	0.00	27.3	97.1 84.2 1	2,653.128.93		2,653,128.93	
37	ARBEN MAJDA		LALA LALA	TRIANË	8170	3/995	TRUALL	290.9	290.9	249.4	35	16 1	99	32878	2,959,026.00					2,959,026.00	
38	MAJDA	ARBEN	LALA	TRIANË	8170	3/995+1-1	APARTA MINT	109.9	0	0	33	22 0	0	0	0.00	4.38	97.1 84.2 1	425,666.84		425,666.84	
39	ARBEN	QAMIL	LALA	TRIANË	8170	3/995/ND- N3	NJËSI	158.75	0	0	33	21 9	0	0	0.00			10.7	171.524.64	171,524.64	
VLERJA TOTALE														3,828.77		493.25		179.79		133,729,848.00	

VENDIM
Nr. 492, datë 10.9.2025

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES
NDRYSHUESE ME SHKËMBIM
NOTASH TË MARRËVESHJES SË
BASHKËPUNIT, NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
BASHKIMIT EVROPIAN, PËR
PROJEKTIN “EU4SCHOOLS”, FAZA E
DYTË, MIRATUAR ME VENDIMIN NR.
548, DATË 27.7.2022, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e

zëvendëskryeministrit dhe ministër të Infrastukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim notash të marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për projektin “EU4SCHOOLS”, faza e dytë, miratuar me vendimin nr. 548, datë 27.7.2022, të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

DREJTORIA E RINDËRTIMIT

Nr. 2619/1 prot.Tiranë, më 18.04. 2025

Lënda: Ndryshimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me shkëmbim notash.

Z. SILVIO GONZATO,
AMBASADOR I DELEGACIONIT TË BASHKIMIT EVROPIAN NË SHQIPËRI
ABA Business Center, Rr. Papa Gjon Pali II, Kati 17, Tiranë

Për dijeni: **ZNJ. RANDI DAVIS,**
PËRFAQËSUESE E PËRHERSHME E PROGRAMIT PËR ZHVILLIM TË
KOMBEVE TË BASHKUARA (UNDP)
Rruga Skënderbej, Kati 2, Tiranë

Së pari, më lejoni t'ju shpreh falenderimet tona për mbështetjen e dhënë dhe punën e bërë në kuadër të rikonstruksionit dhe rindërtimit të objekteve arsimore të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26.11.2019.

Në vijim të shkresës Suaj nr.2025 (601432), datë 27.01.2025, dhe për efekt të ndjekjes së procedurave të brendshme ligjore, ju përcjellim notën për ndryshimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, me shkëmbim notash, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për projektin “EU4SCHOOLS”, faza e dytë, të miratuar me Vendimin nr.548, datë 27.7.2022 të Këshillit të Ministrave.

Gjatë zbatimit të programit, UNDP (Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara), në cilësinë e implementuesit të projektit ka kërkuar ndryshimin e listës së objekteve arsimore që do të rindërtohen ose rikonstruktohen nga projekti “EU4SCHOOLS”, faza e dytë.

Ndryshimi i kërkuar konsiston në rindërtimin e 24 objekteve arsimore dhe rikonstruksionin e 16 të tjerave, dhe pasqyrohet në tabelën si më poshtë:

Nr.	Objekti arsimor	Tipi	Bashkia	Tipologjia e ndërhyrjes
1	Varosh	Kopsht	Bashkia Krujë	Ndërtim
2	Shkollë Bilaj	9- vjeçare + Kopsht	Bashkia Krujë	Ndërtim

Adresa: Rruga “Abdi Toptani” Nr.1, Tiranë, Faqja Web: <http://www.infrastruktura.gov.al>



3	Gjergj Kastrioti	9- vjeçare	Bashkia Lezhë	Ndërtim
4	Fran Ivanaj	9- vjeçare + Kopsht	Bashkia Lezhë	Rikonstruksion
5	Naim Frashëri	Shkollë e mesme	Bashkia Durrës	Ndërtim
6	Kushtrimi i Lirisë	9- vjeçare+ Kopsht	Bashkia Durrës	Rikonstruksion
7	Olsi Lasko	Shkollë e mesme	Bashkia Durrës	Ndërtim
8	Eftali Koci	9- vjeçare+ Kopsht	Bashkia Durrës	Ndërtim
9	Nr.3	Çerdhe	Bashkia Durrës	Rikonstruksion
10	Kopshti Bizë	Kopsht	Bashkia Durrës	Ndërtim
11	Bernardina Qerraxhi	Shkollë e mesme profesionale	Bashkia Durrës	Ndërtim
12	Bernardina Qerraxhi	Konvikt	Bashkia Durrës	Ndërtim
13	Shkolla Karpen	9- vjeçare	Bashkia Kavajë	Rikonstruksion
14	3 Dëshmorët	9-vjecare	Bashkia Kavajë	Rikonstruksion
15	Charles Telford Erickson	Shkollë e mesme profesionale	Bashkia Kavajë	Rikonstruksion
16	Cerdhe Babrru	Çerdhe	Bashkia Kamëz	Ndërtim
17	Jashar Hoxha	Kopsht	Bashkia Kamëz	Rikonstruksion
18	Ibrahim Basha	9-vjeçare + Kopsht	Bashkia Kamëz	Rikonstruksion
19	Kryevidh	9-vjeçare + Kopsht	Bashkia Rogozhinë	Ndërtim
20	Rreth-Greth	9-vjeçare + Kopsht	Bashkia Rogozhinë	Ndërtim
21	Xhorxh Sorros	9-vjecare	Bashkia Rogozhinë	Rikonstruksion
22	Okshtun	Kopsht	Bashkia Rogozhinë	Ndërtim
23	Vilë Bashtovë	9-vjeçare + Kopsht	Bashkia Rogozhinë	Ndërtim
24	Bërxullë	9-vjeçare	Bashkia Vorë	Ndërtim
25	Vorë	9-vjeçare	Bashkia Vorë	Ndërtim
26	Kopshti Nr. 41	Kopsht	Bashkia Tiranë	Rikonstruksion
27	Musine Kokalari	9-vjeçare + Kopsht	Bashkia Tiranë	Ndërtim dhe Rikonstruksion
28	26 Nëntori	9- vjeçare + Kopsht	Bashkia Tiranë	Rikonstruksion
29	Emin Duraku	9- vjeçare + Kopsht	Bashkia Tiranë	Ndërtim
30	Xhezmi Delli	9- vjeçare + Kopsht	Bashkia Tiranë	Ndërtim
31	Asim Vokshi	Shkollë profesionale	Bashkia Tiranë	Rikonstruksion
32	Kopshti Nr.1	Kopsht	Bashkia Kurbin	Ndërtim
33	Kopsht & Cerdhe Rubik	Kopsht+Çerdhe	Bashkia Mirditë	Ndërtim
34	Kopshti Nr. 2	Kopsht	Bashkia Shijak	Ndërtim
35	Rilindja	9- vjeçare + Kopsht	Bashkia Shijak	Ndërtim
36	Beqir Çela	Konvikt	Bashkia Durrës	Ndërtim
37	14 Nëntori	9-vjecare+Kopsht	Bashkia Durrës	Rikonstruksion
38	Myslym Keta	Shkolla e Mesme	Bashkia Tiranë	Rikonstruksion
39	Cerdhe Nr. 2	Çerdhe	Bashkia Durrës	Rikonstruksion
40	Kopshti Manzë	Kopshti	Bashkia Durrës	Ndërtim



Nota Juaj, së bashku me këtë notë do të përbëjnë marrëveshjen ndryshuese me shkëmbim notash të Marrëveshjes së Bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për Projektin “EU4SCHOOLS”, Faza e Dytë, e cila do të hyjë në fuqi pas përfundimit të procedurave të brendshme ligjore.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin,


ZËVËNDËSKRYEMINISTËR

DHE

MINISTËR

Belinda Balluku





BASHKIMI EVROPIAN

Delegacioni në Shqipëri
Kreu i BashkëpunimitBASHKIMI
EVROPIANDelegacioni në Shqipëri
Shefi për Bashkëpunimin
Financiar
E nderuar Znj. Belinda Balluku
Zëvendëskryeministre
Ministre e Infrastrukturës dhe
Energjisë
Rruga "Abdi Toptani" Nr. 4
Tiranë - ShqipëriTiranë, 26/05/2025
Ares (2025) 4240744**Lënda: Korrigjimi i shkresës së datës 22 maj 2025**

Referenca: Gabim drejtshkrimor i Numrit të Protokollit në shkresë

E nderuar Zëvendëskryeministre ,


Ju lutem gjeni bashkëlidhur shkresën e rishikuar në lidhje me shkresën e konfirmimit mbi Ndryshimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me shkëmbim notash për projektin EU4schools, të dërguar më 22 maj 2025, Ares (2025) 4141855.

Ndryshimi lidhet me korrigjimin e bërë në numrin e protokollit, të shtypur 268/1 dhe 269/1 , ndërsa i sakti duhet të jetë 2618/1 dhe 2619/1.

Shkresa e saktë që duhet të konsiderohet si miratimi ynë, i është bashkëlidhur kësaj shkrese përcjellëse.

Me respekt,
(Nënshkrimi)
Hubert Perr

Në vëmendje të : Znj. Randy Davis, Përfaqësuese e Përherëshme e PNUD-it

**BASHKIMI EVROPIAN**

Delegacioni në Shqipëri
Kreu i Bashkëpunimit

BASHKIMI EVROPIAN

Delegacioni në Shqipëri
Shefi për Bashkëpunimin Financiar

E nderuar Znj. Belinda Balluku
Zëvendëskryeministër
Ministre e Infrastrukturës dhe
Energjisë
Rruga "Abdi Toptani" Nr. 4
Tiranë - Shqipëri

Tiranë, 26/05/2025,
Ares (2025) 4240744

Lënda: Letër konfirmimi mbi Ndryshimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me
Referenca: shkëmbim notash për projektin EU4schools
Shkresat tuaja të 18 prillit 2025, nr.prot. 2618/1, numri i protokollit tonë Ares (2025)3222254 dhe nr.prot. 2619/1, numri i protokollit tonë Ares (2025)3222609

E nderuar Zëvendëskryeministër,

Delegacioni i BE-së konfirmon marrjen e shkresave nr. 2618/1 dhe 11⁰ 2619/1, të cilat kërkojnë konfirmimin e Ndryshimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Shkëmbim Notash në lidhje me kërkesën e PNUD-it për të modifikuar listën e objekteve arsimore që do të rindërtohen ose rindërtohen në kontekstin e projektit të lartpërmendur.

Lista konsiston në rindërtimin e 10 objekteve arsimore dhe rindërtimin e 13 të tjerave, për fazën I, siç pasqyrohet në tabelën bashkëlidhur shkresës me nr. prot. 2618/1.

Lista tjetër konsiston në rindërtimin e 24 objekteve arsimore dhe rindërtimin e 16 të tjerave, për fazën II, siç pasqyrohet në tabelën bashkëlidhur shkresës me nr. prot. 2619/1.

Në total, 63 objekte arsimore do të përfundojnë në fund të programit.

Nëpërmjet kësaj shkrese, konfirmojmë se jemi dakord me ndryshimet e propozuara të dakordësuara nga Komiteti Shtetëror për Rindërtimin.

Me respekt,
(Nënshkrimi)
Hubert Perr

Në vëmendje të: Znj. Randy Davis, Përfaqësuese e Përhershme e PNUD-it.

**VENDIM****Nr. 493, datë 10.9.2025**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES
NDRYSHUESE ME SHKËMBIM NOTASH
TË MARRËVESHJES SË
BASHKËPUNIT, NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
BASHKIMIT EVROPIAN, PËR
PROJEKTIN “EU4SCHOOLS”,
MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 635,
DATË 29.7.2020, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim notash të marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për projektin “EU4SCHOOLS”, miratuar me vendimin nr. 635, datë 29.7.2020, të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E RINDËRTIMIT

Nr. 2618/1 prot.

Tiranë, më 18.04. 2025

Lënda: Ndryshimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me shkëmbim notash.

Z. SILVIO GONZATO,
AMBASADOR I DELEGACIONIT TË BASHKIMIT EVROPIAN NË SHQIPËRI
ABA Business Center, Rr. Papa Gjon Pali II, Kati 17, Tiranë

Për dijeni: **ZNJ. RANDI DAVIS,**
PËRFAQËSUESE E PËRHERSHME E PROGRAMIT PËR ZHVILLIM TË
KOMBEVE TË BASHKUARA (UNDP)
Rruga Skënderbej, Kati 2, Tiranë

Së pari, më lejoni t'ju shpreh falenderimet tona për mbështetjen e dhënë dhe punën e bërë në kuadër të rikonstruksionit dhe rindërtimit të objekteve arsimore të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26.11.2019.

Në vijim të shkresës Suaj nr.2025 (601432), datë 27.01.2025, dhe për efekt të ndjekjes së procedurave të brendshme ligjore, ju përcjellim notën për ndryshimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, me shkëmbim notash, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për projektin "EU4SCHOOLS", të miratuar me Vendimin nr.635, datë 29.7.2020 të Këshillit të Ministrave.

Gjatë zbatimit të programit, UNDP (Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara), në cilësinë e implementuesit të projektit "EU4SCHOOLS" ka kërkuar ndryshimin e listës së objekteve arsimore që do të rindërtohen ose rikonstruktohen nga projekti i lartëpërmendur. Ndryshimi i kërkuar konsiston në rindërtimin e 10 objekteve arsimore dhe rikonstruksionin e 13 të tjerave, dhe pasqyrohet në tabelat si më poshtë:

a) Objekte arsimore që do të rindërtohen:

1.	Bashkia Krujë	NJA Krujë	Kopsht	"Derete"	Ndërtim
2.	Bashkia Krujë	NJA Nikël	9-vjeçare	Korb Muça (Qerekë)	Ndërtim
3.	Bashkia Krujë	NJA Nikël	9-vjeçare	Sherif Dervish (Budull)	Ndërtim
4.	Bashkia Krujë	NJA Thumanë	E mesme e bashkuar	"Haxhi Qira Borizan"	Ndërtim
5.	Bashkia Krujë	NJA Thumanë	Kopësht	Kopshti Borizan	Ndërtim
6.	Bashkia Kurbin	NJA Laç	Kopësht	Kopshti Nr.2	Ndërtim

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" Nr.1, Tiranë, Faqja Web: <http://www.infrastruktura.gov.al>



7.	Bashkia Kurbën	NJA Laç	9-vjeçare	Gjokë Elezi (Sanxhak)	Ndërtim
8.	Bashkia Durrës	NJA Sukth	E mesme e bashkuar	Ismet Nanushi	Ndërtim
9.	Bashkia Durrës	NJA Sukth	Kopësht	Ismet Nanushi	Ndërtim
10.	Bashkia Kamëz	NJA Laknas	Kopësht	“Dom Nikollë Kaçorri”	Ndërtim

b) Objekte arsimore që do të rikonstruktohen:

11.	Bashkia Durrës	NJA Durrës	Kopësht	“I Qershori”	Rikonstruksion
12.	Bashkia Durrës	NJA Sukth	E mesme	“Dhosi Liperi”	Rikonstruksion
13.	Bashkia Durrës	NJA Durrës	E mesme profesionale	“Hysen Cela”	Rikonstruksion
14.	Bashkia Durrës	NJA Radë	9-vjeçare	“Riza Shera”	Rikonstruksion
15.	Bashkia Krujë	NJA Krujë	E mesme	“Skëndërbeu”	Rikonstruksion
16.	Bashkia Krujë	NJA Thumanë	9-vjeçare	“Bushnesh”	Rikonstruksion
17.	Bashkia Kurbën	NJA Laç	Shkollë	“Fushë Milot”	Rikonstruksion
18.	Bashkia Kurbën	NJA Laç	Shkollë	“Malbardhe”	Rikonstruksion
19.	Bashkia Kurbën	NJA Mamurras	9-vjeçare	“Demokracia”	Rikonstruksion
20.	Bashkia Kamëz	NJA Laknas	9-vjeçare	“Dom Nikollë Kaçorri”	Rikonstruksion
21.	Bashkia Kamëz	NJA Paskuqan	9-vjeçare	“Tahir Sinani”	Rikonstruksion
22.	Bashkia Kavajë	NJA Kavajë	9-vjeçare	“Mehment Babamusta”	Rikonstruksion
23.	Bashkia Kavajë	NJA Kavajë	9-vjeçare	“Fiqiri Kurti”	Rikonstruksion

Nota Juaj, së bashku me këtë notë do të përbëjnë marrëveshjen ndryshuese me shkëmbim notash të Marrëveshjes së Bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për Projektin “EU4SCHOOLS”, e cila do të hyjë në fuqi pas përfundimit të procedurave të brendshme ligjore.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin,


ZËVËNDËSKRYEMINISTËR

DHE

MINISTËR

Belinda Balluku





BASHKIMI EVROPIAN

Delegacioni në Shqipëri
Kreu i BashkëpunimitBASHKIMI
EVROPIANDelegacioni në Shqipëri
Shefi për Bashkëpunimin
Financiar
E nderuar Znj. Belinda Balluku
Zëvendëskryeministre
Ministre e Infrastrukturës dhe
Energjisë
Rruga "Abdi Toptani" Nr. 4
Tiranë - ShqipëriTiranë, 26/05/2025
Ares (2025) 4240744**Lënda: Korrigjimi i shkresës së datës 22 maj 2025**

Referenca: Gabim drejtshkrimor i Numrit të Protokollit në shkresë

E nderuar Zëvendëskryeministre ,


Ju lutem gjeni bashkëlidhur shkresën e rishikuar në lidhje me shkresën e konfirmimit mbi Ndryshimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me shkëmbim notash për projektin EU4schools, të dërguar më 22 maj 2025, Ares (2025) 4141855.

Ndryshimi lidhej me korrigjimin e bërë në numrin e protokollit, të shtypur 268/1 dhe 269/1 , ndërsa i sakti duhet të jetë 2618/1 dhe 2619/1.

Shkresa e saktë që duhet të konsiderohet si miratimi ynë, i është bashkëlidhur kësaj shkrese përcjellëse.

Me respekt,
(Nënshkrimi)
Hubert Perr

Në vëmendje të : Znj. Randy Davis, Përfaqësuese e Përhershme e PNUD-it

**BASHKIMI EVROPIAN**

Delegacioni në Shqipëri
Kreu i Bashkëpunimit

BASHKIMI EVROPIAN

Delegacioni në Shqipëri
Shefi për Bashkëpunimin Financiar

E nderuar Znj. Belinda Balluku
Zëvendëskryeministër
Ministre e Infrastrukturës dhe
Energjisë
Rruga "Abdi Toptani" Nr. 4
Tiranë - Shqipëri

Tiranë, 26/05/2025,
Ares (2025) 4240744

Lënda: Letër konfirmimi mbi Ndryshimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me
Referenca: shkëmbim notash për projektin EU4schools
Shkresat tuaja të 18 prillit 2025, nr.prot. 2618/1, numri i protokollit tonë Ares (2025)3222254 dhe nr.prot. 2619/1, numri i protokollit tonë Ares (2025)3222609

E nderuar Zëvendëskryeministër,

Delegacioni i BE-së konfirmon marrjen e shkresave nr. 2618/1 dhe 11⁰ 2619/1, të cilat kërkojnë konfirmimin e Ndryshimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Shkëmbim Notash në lidhje me kërkesën e PNUD-it për të modifikuar listën e objekteve arsimore që do të rindërtohen ose rindërtohen në kontekstin e projektit të lartpërmendur.

Lista konsiston në rindërtimin e 10 objekteve arsimore dhe rindërtimin e 13 të tjerave, për fazën I, siç pasqyrohet në tabelën bashkëlidhur shkresës me nr. prot. 2618/1.

Lista tjetër konsiston në rindërtimin e 24 objekteve arsimore dhe rindërtimin e 16 të tjerave, për fazën II, siç pasqyrohet në tabelën bashkëlidhur shkresës me nr. prot. 2619/1.

Në total, 63 objekte arsimore do të përfundojnë në fund të programit.

Nëpërmjet kësaj shkrese, konfirmojmë se jemi dakord me ndryshimet e propozuara të dakordësuara nga Komiteti Shtetëror për Rindërtimin.

Me respekt,
(Nënshkrimi)
Hubert Perr

Në vëmendje të: Znj. Randy Davis, Përfaqësuese e Përhershme e PNUD-it.



VENDIM

Nr. 497, datë 10.9.2025

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 549, DATË 4.9.2024,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRDORIMIN E MJETEVE AJRORE PA
PILOT NË ADMINISTRIM TË FORCAVE
TË ARMATOSURA NË MBËSHETJE
TË INSTITUCIONEVE SHTETËRORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 7978, datë 26.7.1995, “Për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të pikës 5, të nenit 24, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 549, datë 4.9.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e mjeteve ajrore pa pilot në administrim të Forcave të Armatosura në mbështetje të institucioneve shtetërore”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në kreun I, pas fjalës “... shtetërore ...” shtohen fjalët “... ose subjekte tregtare me kapital shtetëror ...”.

2. Në pikën 1, të kreut II, pas fjalëve “... një apo më shumë institucione ...” shtohen “... ose subjekte tregtare me kapital shtetëror ...”.

3. Në kreun III bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Në pikën 1 bëhen këto shtesa:

i. Pas shkronjës “ë” shtohet shkronja “f”, me këtë përmbajtje:

“f) ministria përgjegjëse për financat dhe institucionet në varësi;”.

ii. Pas shkronjës “f” shtohet shkronja “g”, me këtë përmbajtje:

“g) ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe institucionet në varësi;”.

b) Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Subjektet tregtare me kapital shtetëror, në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin e tyre të posaçëm, kërkojnë dhe marrin shërbimin e mjeteve ajrore pa pilot të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Marrja e

këtij shërbimi ofrohet kundrejt tarifës, e cila përcaktohet me urdhër të përbashkët të ministrit të Mbrojtjes dhe ministrit të Financave.”.

c) Në pikën 9, fjalët “Institucionet shtetërore, të përcaktuara në pikën 1...” zëvendësohen me “Subjektet e përcaktuara në pikat 1 dhe 1/1 ...”.

ç) Në pikën 10, fjalët “... institucioneve shtetërore, të përcaktuara në pikën 1 ...” zëvendësohen me “... subjekteve të përcaktuara në pikat 1 dhe 1/1 ...”.

d) Në pikën 12, fjalët “... institucioneve të përcaktuara në pikën 1 ...” zëvendësohen me “... subjekteve të përcaktuara në pikat 1 dhe 1/1 ...”.

4. Në kreun IV bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 1 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

i. Në pjesën hyrëse, fjalët “... institucioneve shtetërore sipas pikës 1 ...” zëvendësohen me “... subjekteve sipas pikave 1 dhe 1/1 ...”.

ii. Pas shkronjës “l” shtohen shkronjat “ll” dhe “m”, me këtë përmbajtje:

“ll) mbikëqyrjen, monitorimin dhe kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *cannabis-it* dhe të prodhimit të nënprodukteve, produkteve të saj për qëllime mjekësore e industriale, sipas legjislacionit në fuqi.

m) mbikëqyrjen dhe monitorimin e transportit e të lëvizjes së mallrave që ndjekin një regjim të caktuar doganor.”.

b) Në pikën 3, fjalët “... institucionet e përcaktuara në pikën 1 ...” zëvendësohen me “... subjektet e përcaktuara në pikat 1 dhe 1/1 ...”.

5. Në kreun V bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në pikën 1, fjalët “Institucionet shtetërore të ...” zëvendësohen me “Subjektet e ...”.

b) Në pikën 5, fjalët “Institucionet shtetërore ...” zëvendësohen me “Subjektet e përcaktuara në kreun III ...”.

II. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe institucionet shtetërore të përmendura në kreun III për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



VENDIM

Nr. 498, datë 10.9.2025

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES
NDRYSHUESE ME SHKËMBIM
LETRASH TË MARRËVESHJES SË
HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM, PËR FINANCIMIN
SHITESË PËR PROJEKTIN E
ZHVILLIMIT TË INTEGRUAR URBAN
DHE TURIZMIT, RATIFIKUAR ME
LIGJIN NR. 70/2022**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim letrash të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin shtesë për projektin e zhvillimit të integruar urban dhe turizmit, ratifikuar me ligjin nr. 70/2022, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**



1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BORXHIT SHTETËROR
DREJTORIA E MARRËVESHJEVE DHE SIGURIMIT TË NDIHMËS SË HUAJ

Nr. 15268 / Prot. 8

Tiranë, më 8 / 5 /2025

Lënda: Mbi Projektin "Zhvillimi i Integruar Urban dhe Turizmi"

ZYRËS SË BANKËS BOTËRORE
Adresa: "Dëshmorët e 4 Shkurtit", nr. 34, Tiranë ✓


Në vëmendje të: **XIAOQING YU**
Drejtoresh Rajonale, Ballkani Perëndimor

Referuar Marrëveshjes së Huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin shtesë për Projektin e "Zhvillimit të Integruar Urban dhe Turizmit", me qëllim finalizimin e suksesshëm të aktiviteteve për t'u financuar nga kjo marrëveshje nëpërmjet kësaj shkrese ju përcjellim kërkesën e palës shqiptare si vijon:

- shtyrjen deri më 30 Qershor 2026, të afatit të parashikuar sipas skedulit 2, seksionit III, pika B të Marrëveshjes së Huasë për financimin shtesë.

Kjo letër së bashku me letrën tuaj të përgjigjes do të përbëjnë marrëveshjen ndryshuese, me shkëmbim letrash të Marrëveshjes së Huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin shtesë për Projektin e "Zhvillimit të Integruar Urban dhe Turizmit".

Ky ndryshim hyn në fuqi, në datën e njoftimit nga pala shqiptare të Bankës Botërore mbi përfundimin e procedurave të brendshme ligjore.





Logo **BANKA BOTËRORE**
BNRZH – IDA- GRUPI I BANKËS BOTËRORE

GRUPI I BANKËS BOTËRORE
Praterstrasse 31/21
Vienna, Austria, 1020

XIAOQING YU
Drejtör, Ballkani Perëndimor
Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore

29 maj 2025

Drejtuar: SH.T. Petrit Malaj
Ministër
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi Dëshmorët e Kombit Nr. 3, Tiranë
REPUBLIKA E SHQIPËRISË

I nderuar Z. Ministër,

*Financim shitesë për Projektin “Zhvillimi i Integruar Urban dhe Turizmi”
(Huaqja BNRZH nr. 9326- AL)
Zgjatja e Datës së Mbylljes*

I referohemi Marrëveshjes së Huasë ndërmjet Shqipërisë (“Huamarrësi”) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka”) të datës 29 korrik 2022, për Projektin e lartpërmendur, dhe letrës tuaj të datës 8 maj 2025, me anë të së cilës Bankës i kërkohet zgjatja e Datës së Mbylljes të huasë së ofruar të lartpërmendur, të parashikuar sipas Marrëveshjes së Huasë.

Kam kënaqësinë t’iu informoj se Banka ka caktuar datën 30 qershor 2026 si datën më të vonshme për qëllime të Seksionit III.B.2 të Skedulit 2 të Marrëveshjes së Huasë.

Me respekt,
(Nënshkrimi)

Xiaoqing Yu
Drejtör Rajonal për Ballkanin Perëndimor
Rajonin e Evropës dhe Azisë Qendrore

Në vëmendje të: SH.S. Belinda Balluku, Zëvendëskryeministre dhe Ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë
SH.T. Blendi Gonxhja, Ministër i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
SH.S. Mirela Kumbaro-Furxhi, Ministre e Turizmit dhe Mjedisit
Znj. Erjona Bejleri, Zëvendës Ministre e Financave
Z. Sokol Duma, Zëvendës Ministër i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
Z. Hantin Bonati, Zëvendës Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë
Z. Dritan Agolli, Drejtör Ekzekutiv, Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH)
Znj. Eridana Çano, Drejtore e SASPAC-ut
Z. Matteo Bugamelli, Drejtör Ekzekutiv, Banka Botërore

Tel: +43 (1) 2170 782 Faks: +43 (1) 2170 701

**VENDIM****Nr. 501, datë 10.9.2025****PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 466, DATË 30.7.2021,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E STRATEGJISË SË
ZHVILLIMIT TË BIZNESIT DHE
INVESTIMEVE, 2021– 2027, DHE TË
PLANIT TË SAJ TË VEPRIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në Strategjinë e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021–2027, bashkëlidhur vendimit nr. 466, datë 30.7.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve, 2021–2027, dhe të planit të saj të zhvillimit”, bëhen këto ndryshime:

1. Kudo në përmbajtjen e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021–2027, emërtimet “Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE)” dhe “Ministria e Financave dhe Ekonomisë” zëvendësohen me fjalët “... ministria përgjegjëse për ekonominë ...”.

2. Në tabelën 11 “Masat në fushën e ndërhyrjes “Tërheqja e investimeve dhe ndërkombëtarizimi”, veprimi prioritar “Programi i zhvillimit të ofruesve” zëvendësohet me veprimin prioritar “Vlerësimi i modelit të diplomacisë ekonomike”, sipas aneksit nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Në tabelën 12 “Masat në fushën e ndërhyrjes “Zhvillimi i NVM-ve, sipërmarrja dhe inovacioni”” bëhen këto ndryshime:

a) Veprimi prioritar “Skema për mbështetjen e sipërmarrjes me bazë konkurrencën” zëvendësohet me veprimin prioritar “Lidhja mes NMVM-ve dhe *startup*-eve”, sipas aneksit nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) Veprimi prioritar “Fuqizimi i ekosistemit të *startup*-eve” zëvendësohet me veprimin prioritar “Akses në programet e Bashkimit Evropian në fushën e biznesit”, sipas aneksit nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Në tabelën 13 “Masat në fushën e ndërhyrjes “Zhvillimi i kapitalit njerëzor”, veprimi prioritar “Program për zhvillimin e forcës së punës për dhe me NVM-të dhe investitorët” zëvendësohet me veprimin “Sensibilizimi dhe përfshirja e bizneseve në reformat e sistemit të VET-së”, sipas aneksit nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Aneksi 1 “Formati i planit të veprimit i përmbledhur” zëvendësohet me aneksin nr. 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

II. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Agjencia Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e *Startup*-eve dhe Lehtësuesve, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**



ANEKSI NR. 1

Veprimet prioritare	Përshkrim përmblledhës
Vlerësimi i modelit të diplomacisë ekonomike	Modeli ekzistues i diplomacisë ekonomike do të vlerësohet bazuar në takime teknike me ekspertë dhe palë të interesuara (si, p.sh., ministritë, agjencitë, misionet diplomatike, shoqatat e biznesit dhe ekspertët ndërkombëtarë), si edhe në një analizë të përvojës dhe praktikës më të mirë ndërkombëtare. Objektivat që synohen janë: - Rritja e efektivitetit dhe eficiencës së aktiviteteve të diplomacisë ekonomike; - Promovimi i interesave ekonomike dhe marrëdhënieve që nxisin integrimin rajonal dhe në BE. Aktiviteti Vlerësimi i modelit ekzistues të diplomacisë ekonomike dhe identifikimi i opsioneve të reformës në periudhën 2025–2027. Institucionet përgjegjëse: MEPJ, MEKI dhe AIDA

Treguesit e performancës dhe vlerat e synuara

Treguesit	Baza bazë (viti 2024)	Vlera e synuar		
		2025	2026	2027
Vlerësimi i kryer		Vlerësimi u finalizua		
Kuadri ligjor/rregullator për modelin e reformuar të diplomacisë ekonomike			Miraturar	

ANEKSI NR. 2

Veprimet prioritare	Përshkrim përmblledhës
Lidhja mes NMVM-ve dhe startup-eve	Aktualisht nevojitet një integrim më i mirë i ekosistemit të <i>startup</i>-eve në ekonomi, ndaj fokusi kryesor i kësaj mase të re është organizimi i disa aktiviteteve ndërgjegjësuere me biznese <i>startup</i> dhe bizneset e krijuara, NMVM-të (takime me fokus tema të caktuara, si p.sh., Automatizimi, AI etj.). Për të gjeneruar sinergji dhe për të bashkuar në mënyrë efektive komunitetin e <i>startup</i>-eve dhe biznesit, AIDA dhe Agjencia e <i>Startup</i>-eve do të bashkëpunojnë ngushtë në përgatitjen e aktiviteteve të përbashkëta, duke ftuar pjesëmarrës dhe duke rritur ndërgjegjësimin për mundësitë e projekteve dhe rezultateve të inovacionit. Objektivat që synohen janë: - Nxitja e lidhjeve midis <i>startup</i>-eve dhe bizneseve të krijuara, duke u fokusuar në potencialet e inovacionit në kontekstin e transformimit digjital, të gjelbër dhe qarkullues; - Integrimi më i fuqishëm i ekosistemit <i>startup</i> në ekonomi. Aktiviteti: Organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere me <i>startup</i>-e dhe i bizneseve NMVM në periudhën 2025–2027. Institucionet përgjegjëse: AIDA dhe Agjencia “<i>Startup Albania</i>”

Treguesit e performancës dhe vlerat e synuara

Treguesit	Baza bazë (viti 2024)	Vlera e synuar		
		2025	2026	2027
Nr. i aktiviteteve të organizuara		1	2	2
Numri i pjesëmarrësve (të paktën 30% <i>startup</i> -e dhe biznese të udhëhequra nga gratë)		30	60	60



ANEKSI NR. 3

Veprimet prioritare	Përshkrim përmbledhës
Akses në programet e Bashkimit Evropian në fushën e biznesit	Për NMVM-të dhe bizneset <i>startup</i> do të mundësohet pjesëmarrja në aplikimet e programeve të BE-së, si Programi i Tregut të Përbashkët 2021–2027 për të mundësuar bashkëpunimin e bizneseve në nivel ndërkombëtar dhe përmirësuar aksesin në financa. NMVM-të dhe <i>startup</i>-et e interesuara do të ndihmohen në gjetjen e partneriteteve për konsorcium dhe përgatitjen e dokumenteve të aplikimit. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) si koordinator i projektit “<i>Enterprise Europe Network-ALBANIA</i>” për periudhën 2022–2025 (42 muaj), do të mundësojë integrimin ndërkombëtar të NMVM-ve dhe rritje të konkurrueshmërisë së tyre. Objektivat që synohen janë: - Forcimi i inovacionit duke shfrytëzuar potencialin e bashkëpunimit në nivel ndërkombëtar; - Nxitja e lidhjeve dhe integritit ndërkombëtar të ekosistemit të inovacionit; - Përmirësimi i aksesit në financë, duke siguruar akses të barabartë për gra dhe burra. Aktiviteti: Mbështetje për NMVM-të dhe bizneset <i>startup</i> për të marrë pjesë në programet e BE-së (Programin e Tregut të Përbashkët 2021–2027) në periudhën 2025–2027. Institucionet përgjegjëse: MEKI, AIDA dhe Agjencia Startup Albania.

Treguesit e performancës dhe vlerat e synuara

Treguesit	Baza bazë (viti 2024)	Vlera e synuar		
		2025	2026	2027
Numri i NMVM-ve që kanë aplikuar me sukses për programet evropiane		2	3	5



ANEKSI NR. 4

Veprimet prioritare	Përshkrim përmblledhës
Sensibilizimi dhe përfshirja e bizneseve në reformat e sistemit të VET-ësë	Ky veprim adreson nevojën për sensibilizimin dhe përfshirjen e bizneseve në prezantimin e modelit të dyfishtë të VET-së. Zhvillimi i tryezave të rrumbullakëta me agjenci shtetërore dhe shoqatat e biznesit do të zhvillohen për të paraqitur dhe diskutuar tiparet kryesore të modelit të dyfishtë të VET-së. Bazuar në këto konsultime do të identifikohen nevojat kryesore të bizneseve. Sensibilizimi dhe përfshirja e bizneseve në procesin e integritimit më të fuqishëm të aftësive të ekonomisë digjitale, të gjelbër në sistemin e VET-së përbën një aktivitet të rëndësishëm që përfshin identifikimin e nevojave të bizneseve, bazuar në studimet e kërkesave për aftësi dhe integrimin e bizneseve në grupet e punës. •Konsultime të mëtejshme do të zhvillohen për të analizuar gjetjet dhe për të përgatitur rishikimin e kurrikulave ekzistuese apo të zhvillimit të kurrikulave të reja. •Pajisja e bizneseve me aftësitë e nevojshme për transformimin digjital dhe të gjelbër. •Nxitja e lidhjeve të forta ndërmjet institucioneve arsimore dhe bizneseve. Aktiviteti: Ndërgjegjësimi dhe përfshirja e bizneseve në prezantimin e modelit të VET-së në periudhën 2025–2027. Institucionet përgjegjëse: MEKI dhe AKPA

Treguesit e performancës dhe vlerat e synuara

Treguesit	Baza bazë (viti 2024)	Vlera e synuar		
		2025	2026	2027
Numri i aktiviteteve, në të cilat prezantohen/diskutohet me bizneset modeli i VET-së.		5	5	
Nr. i kurrikulave të rishikuara/të reja me përfshirjen e bizneseve në studimet dhe konsultime.		5	5	



ANEKSI NR. 5
FORMATI I PLANIT TË VEPRIMIT I PËRMBLEDHUR

PLANI I VEPRIMIT NË ZBATIM TË DOKUMENTIT STRATEGJIK (2021–2027)

I. QËLLIMI STRATEGJIK: “Një ekonomi shqiptare konkurruese, e nxitur nga inovacioni dhe e bazuar në njohuri, e cila krijon vende pune të reja dhe më cilësore, duke shfrytëzuar mundësitë që ofron transformimi digjital dhe transformimi i zinxhirit të vlerave ndërkombëtare, me theksin mbi zhvillimin e qëndrueshëm, integrimin evropian dhe atë rajonal”

II. QËLLIMI I POLITIKËS: Zhvillimi plotësisht i potencialeve të investimeve për zhvillimin ekonomik dhe nxitjen e integritit në tregjet ndërkombëtare dhe zinxhirët e vlerës

III. PROGRAMI BUXHETOR: Programi buxhetor i MEKI 04130 “Mbështetje për zhvillimin ekonomik”

Nr.	Objektivi specifik,produkti, masa	Produkti	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Totali 2021–2027				Komente
							Kostoja indikative	Burimi i financimit		Hendeku financiar	
			Institucioni udhëheqës	Institucion kontribues	Afati i fillimit	Afati i mbarimit		Buxheti i Shtetit Programi 04130 “Mbështetje për zhvillimin ekonomik”	Financimi i huaj		
1.1	Tërheqja e investimeve dhe ndërkombëtarizimi	-Rritja e fluksit të investimeve nga 7.6 në9% të PBB-së - Rritja e totalit të eksportit të mallrave dhe shërbimeve nga 31.5% në 36% të PBB-së -Rritja e vlerësimit në indeksin e politikave për NVM-të (integrimi iNVM-ve në zinxhirin e vlerave globale) nga 1.1 në 3.1	AIDA	Ministri përgjegjës për ekonominë, MEPJ, MIE, MTM, MBZHR, BDHTI dheshoqatat e biznesit	TM1-2021	TM4-2027	152,706,415	66,882,383	1,601,100	(84,222,932)	Ishte
1.1	Tërheqja e investimeve dhe ndërkombëtarizimi	- Rritja e fluksit të investimeve nga 7.6 në 9% të PBB-së - Rritja e totalit të eksportit të mallrave dhe shërbimeve nga 31.5% në 36% të PBB-së - Rritja e vlerësimit në indeksin e politikave për NVM-të (integrimi iNVM-ve në zinxhirin e vlerave globale) nga 1.1 në 3.1	AIDA	Ministri përgjegjës për ekonominë, dheshoqatat e biznesit	2021	2027	125,507,658	94,505,994	1,601,100	(29,400,564)	Bëhet
1.1.1	Promovimi/lehtësimi sistematik i investimeve të synuara	- 7 fushata specifike të targetimit për grupet e synuara - 51 projekte tërheqësetë	AIDA	Ministri përgjegjës për ekonominë, MEPJ, MIE, MTM, MBZHR,	TM1-2021	TM4-2027	30,824,970	16,301,130	-	(14,523,840)	



		investimeve - 127,500 mijë euro volumi i investimeve - Krijimi i 15,300 vendeve pune të reja		BDHTI dheshoqat e biznesit							
1.1.2	Program i strukturuar për shërbimin e përkujdesjes së mëtejshme	- 300 klientë të <i>after-care</i> (investitorët ekzistues) - 20 memorandume mirëkuptimi të nënshkruara me bashki/partner - 160 projekte të riinvestimit - 320,000 mijë EUR vëllimi i riinvestimit - 16,000 vende pune të krijuara nga investitorët ekzistues	AIDA	AIDA, ministri përgjegjës për ekonominë, bashkitë, dhomat dhe shoqatat etregtisë	TM1-2022	TM4-2027	---	-	-	-	
1.1.3	Vlerësimi dhe reforma e programit të TEDA-ve	- Finalizimi i vlerësimit, udhëzuesit të reformës dhe konceptit të zhvillimit (deri në vitin 2022) - 30 ha tokë e zhvilluar/20 ha e përdorur nga investitorët në zonën e zgjedhur - 20 rezident aktivë në zonën e zgjedhur - 3,000 vende pune të reja, të krijuara në zonën e zgjedhur	Ministri përgjegjës për ekonominë	Ministri përgjegjës për ekonominë, Korporata Shqiptare e Investimeve	Vlerësimidhe koncepti i zhvillimit(2021) zbatimi dhe koncepti i zhvillimit (2022)	Vlerësimidhe koncepti i zhvillimit(2022) zbatimi dhe koncepti i zhvillimit (2027)	11,876,724	-	-	(11,876,724)	
	Programi i zhvillimit të ofruesve	- Pjesëmarrje e 30 investitorëve deri në 2027 - Pjesëmarrje e 150 bizneseve lokale deri më 2027 - Lehtësimi i nënkontratave me vlerë 75 milionë euro deri më 2027	AIDA	AIDA, ministri përgjegjës për ekonominë	Faza pilot (2021) zbatimi i programit(faza pilot(2023)	Faza pilot(2024) zbatimi i programit(2027)	62,013,581	7,261,253	-	(54,752,328)	Masë e hequr
1.1.4	Strategjia e eksportit	- Strategjia e eksportit e	Ministri përgjegjës për ekonominë	Grupi i punës	TM2-2022	TM4-2022	120,000	120,000	-	-	
1.1.5	Iniciativa e zhvillimit të biznesit elektronik	- 300 biznese përfituese (2022–2024) - 75 zgjidhje për biznesin elektronik/tregtinë elektronike të miratuara nga përfituesit	Ministri përgjegjës për ekonominë	Ministri përgjegjës për ekonominë, AIDA	TM2-2022	TM3-2024	47,801,100	43,200,000	1,601,100	(3,000,000)	



		- 15% rritje në eksportet e biznesevepërfituesve									
1.1.6	Vlerësimi i modelit të diplomacisë ekonomike	Vlerësimi i modelit ekzistues të diplomacisë ekonomike dhe identifikimi i opsioneve të reformës në periudhën 2025-2027.	Ministri përgjegjës për punët e jashtme	Ministri përgjegjës për ekonominë dhe AIDA	2025	2027	34,884,864	34,884,864	-	-	Masë e re
	Zhvillimi i NVM-ve, sipërmarrja dhe inovacioni	- Rritja e dendësisë së <i>startup</i> -eve nga 88 në 132 (<i>startup</i> -e për një milion banorë) - Rritja e vlerësimit në indeksin e konkurrueshmërisë globale (aftësitë inovative) nga 29.8 në 34 - Rritja e vlerësimit në indeksin e politikave për NVM-të (shërbimet mbështetëse për NVM-të) nga 3.6 në 4.4	Ministri përgjegjës për ekonominë	Ministri përgjegjës për ekonominë, MIE, MTM, MZHBR, Agjencia për Mbështetjen <i>estartup</i> -eve, ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, inkubatorët, përsheptuesit dhe organizatat e mbështetjes së mëtejshme	TM2-2021	TM4-2027	9,271,887,010	6,699,318,082	2,147,163,624	(425,207,520)	Ishte
1.2	Zhvillimi i NVM-ve, sipërmarrja dhe inovacioni	- Rritja e dendësisë së <i>startup</i> -eve nga 88 në 132 (<i>startup</i> -e për një milion banorë) - Rritja e vlerësimit në indeksin e konkurrueshmërisë globale (aftësitë inovative) nga 29.8 në 34 - Rritja e vlerësimit në indeksin e politikave për NVM-të (shërbimet mbështetëse për NVM-të) nga 3.6 në 4.4	Ministri përgjegjës për ekonominë	Ministri përgjegjës për ekonominë, MIE, MTM, MZHBR, Agjencia për Mbështetjen <i>estartup</i> -eve, ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, inkubatorët, përsheptuesit dhe organizatat e mbështetjes së mëtejshme	2021	2027	6,959,107,952	6,483,866,088	50,034,344	(425,207,520)	Bëhet
	Skema për mbështetjen e sipërmarrjes me bazë konkurrencën	- 360 NMVM që marrin pjesë në CoSolve-19 - 150 pjesëmarrës në trajnime çdo vit (të paktën 40% femra) - 30 grante çdo vit (të paktën 40% ndaj grave)	AIDA	AIDA, ministri përgjegjës për ekonominë	TM1-2021	TM4-2027	675,601,114	140,698,714	534,902,400	-	Masë e hequr
1.2.1	Lidhja mes NMVM-ve dhe <i>startup</i> -eve	- Organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere me start	AIDA dhe Agjencia “Start up Albania”	Ministri përgjegjës për ekonominë	2025	2027	5,000,000	-	5,000,000	-	Masë e re



		up-e dhe bizneseve NMVM në periudhën 2025-2027.									
	Fuqizimi i ekosistemit të <i>startup</i> -eve	- Funksionimi i Agjencisë së <i>startup</i>-eve - Regjistruar 375 biznese <i>startup</i> inovative - Shkalla e mbijetesës prej 65% pas 5 vitesh 3,000 vende pune të krijuara nga bizneset <i>startup</i>	Ministri përgjegjës për ekonominë	Agjencia për Mbështetjen e <i>startup</i> -eve, ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarjes, inkubatorët, përsheptuesit dhe organizatat e mbështetjes së mëtejshme	TM1-2021	TM4-2027	1,678,427,280	74,753,280	1,603,674,000	-	Masë e hequr
1.2.2	Akresi në programet e Bashkimit Evropian në fushën e biznesit	- Mbështetje për NMVM-të dhe bizneset <i>startup</i> për të marrë pjesë në programet e BE-së (Programin e Tregut të Përbashkët 2021-2027)	AIDA dhe Agjencia “Start up Albania”	AIDA	2025	2027	36,447,120	-	36,447,120	-	Masë e re
1.2.3	Integrimi ndërkombëtar i ekosistemit të <i>startup</i> -eve	- 30 biznese <i>startup</i> shqiptare dhe 25 mentorë të diasporës që marrin pjesë - 12 organizata mbështetëse shqiptare që bashkëpunojnë me qendrat ndërkombëtare - 25 biznese <i>startup</i> shqiptare që bashkëpunojnë me qendrat ndërkombëtare	Ministri përgjegjës për ekonominë	Ministri përgjegjës për ekonominë, Ministri i Shtetit për Diasporën dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Agjencia për <i>startup</i> -et	Nisma e diasporës për mentorim (2021)	Nisma e diasporës për mentorim (2027)	61,626,528	-	3,619,008	(58,007,520)	
1.2.4	Nisma për përmirësimin e zinxhirit të vlerave me bazë konkurrencën	- 40 aplikime/20 konsorciume të zgjedhura për fazën e konceptit më 2022 - 10 konsorciume të mbështetura në fazën e zbatimit 2023-2024 - 15% rritje në të ardhurat e NVM-ve pjesëmarrëse në vitet 2023 dhe 2027 - 50 vende të reja punetë krijuara nga përfutjesit deri në 2023 dhe	AKKSHI	AIDA, ministri përgjegjës për ekonominë, MASR etj. dhe organizatat të tjerambështetëse	TM1-2022	TM4-2024	367,200,000	-	-	(367,200,000)	



		2027									
1.2.5	Rritje e aksesit në financë për NMVM-të	- 60 përfitues të Fondit të Zhvillimit të NVM-ve çdo vit (2022-2027) - 30% përfitues e sipërmarrëse gra /biznese të drejtuara nga gratë (2022-2027) - 180 vende pune të reja të krijuara nga përfituesit e Fondit çdo vit (2022-2027) - Hartuar një kornizë ligjore dhe nënligjore për NVM-të (deri në 2021) - VKM për skemën e garancisë shtetërore e hartuar (deri në vitin 2023) - Hartuar korniza ligjore për financimin e investimeve <i>crowdfunding</i> - Krijimi i një rrjeti të engjëjve të biznesit	Ministri përgjegjës për ekonominë	AIDA	TM1-2022	TM4-2027	6,451,466,016	6,446,497,800	4,968,216		
1.2.6	Program për aftësitë sipërmarrëse për NVM-të	- 12 trajnime çdo vit. - 300 pjesëmarrës në trajnime çdo vit.	AIDA	Ministri përgjegjës për ekonominë, AKPA, BDHTI dhe shoqatat e biznesit	TM1-2022	TM4-2027	37,368,288	37,368,288	-	-	
1.3	Zhvillimi i kapitalit njerëzor	- Rritje e PBB-së për person të punësuar nga 34,600 në 37,000 (në vitin 2017, PPPkonstante në \$) - Rritje e përqindjes së punësimeve në profesione që kërkojnë njohuri të thelluara nga 17.5% në 19.5% - Rritje e vlerësimit në indeksin e politikave për NVM-të (aftësitë sipërmarrëse) nga 4.3 në 3.9	Ministri përgjegjës për ekonominë	AIDA, MASR, AKKSHI	TM1-2021	TM4-2027	181,140,000	37,700,000	-	(142,440,000)	Ishte
1.3	Zhvillimi i kapitalit njerëzor	- Rritje e PBB-së për person të punësuar nga 34,600 në 37,000 (në vitin 2017, PPPkonstante në \$)	Ministri përgjegjës për ekonominë	AIDA, MASR, AKKSHI	2021	2027	137,980,787	17,740,787	-	(120,240,000)	Bëhet



		- Rritje e përqindjes së punësimeve në profesione që kërkojnë njohuri të thelluara nga 17.5% në 19.5% - Rritje e vlerësimit në indeksin e politikave për NVM-të (aftësitë sipërmarrëse) nga 4.3 në 3.9									
1.3.1	Skema e mbështetjes për zhvillimin e kapitalit njerëzor bashkëpunues	- 150 përfitues (të paktën 40% gra) - 100 NVM që punësojnë talente përtej kohëzgjatjes së mbështetjes	AIDA	Ministri përgjegjës për ekonominë, MASR, AKKSHI	TM2-2023	TM4-2027	108,000,000	-	-	(108,000,000)	
	Program për zhvillimin e fuqisë punëtore për dhe NVM-të dhe investitorët	- 20 memorandume mirëkuptimi me partnerët - 10 investitorë/NVM të mbështetur çdo vit (2021-2023), 25 investitorë/NVM të mbështetur çdo vit (2024-2027) - 40 pjesëmarrës në trajnime çdo vit (2021-2023), 175 pjesëmarrës çdo vit (2024-2027)	AIDA	Ministri përgjegjës për ekonominë, MEPJ, AKPA, bashkitë, qendrat e formimit, dhomat dhe shoqatat e tregtisë	TM4-2021	TM4-2027	60,900,000	-	-	(60,900,000)	Masë e hequr
1.3.2	Sensibilizimi dhe përfshirja e bizneseve në reformat e sistemit të VET-ësë	- Ndërgjegjësimi dhe përfshirja e bizneseve në prezantimin e modelit të VET-ësë në periudhën 2025-2027.	Ministri përgjegjës për politikën e punësimit	Ministri përgjegjës për ekonominë	2025	2027	17,740,787	17,740,787	-	-	Masë e re
1.3.3	Sistemi i parashikimit të nevojave për aftësi	- Sistemi i parashikimit i zhvilluar/ implementuar (deri në vitin 2022) - 3 raporte parashikimi	AKPA	AKAFPK, ministri përgjegjës për ekonominë, MASR, BDHTI dhe shoqatat e biznesit, sektori privat	TM3-2021	TM4-2027	12,240,000	-	-	(12,240,000)	
1.3.4	Vlerësim periodik i nevojave për trajnim	- 1 vlerësim i nevojave për trajnim çdo vit - 250 SME të asistuar çdo vit.	AIDA	AIDA, ministri përgjegjës për ekonominë, AKPA, BDHTI dhe shoqatat e biznesit.	TM4-2021	TM-2027	-	-	-	-	

**VENDIM****Nr. 502, datë 10.9.2025****PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 15, DATË 9.1.2025, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR FINANCIMIN E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE SPITALORE NGA SKEMA E DETYRUESHME E SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR PËR VITIN 2025”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, të ndryshuar, të nenit 10, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 53 të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 15, datë 9.1.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2025”, shtojca nr. 2 zëvendësohet me shtojcën me të njëjtin numër e titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



SHTOJCA NR 2
BUXHETI PËR SHËRBIMIN SPITALOR

EMERTIMI	BUXHETI 2025 SIPAS ARTIKUJVE (000 lekë)						
	art.600	art.601	art.602	Art.602 PPP lab	Art.604	rezerve	total
QSR BERAT	535,100	87,000	200,000	64,000	0	0	886,100
BULQIZE	113,700	18,750	30,000	0	0	0	162,450
DELVINE	54,860	9,220	7,000	0	0	0	71,080
DEVOLL	70,120	11,350	12,000	0	0	0	93,470
DIBER	387,480	63,500	135,000	33,000	0	0	618,980
ELBASAN	690,100	113,950	250,000	110,000	0	0	1,164,050
FIER	559,500	91,950	238,000	115,000	0	0	1,004,450
GRAMSH	176,270	28,650	35,000	0	0	0	239,920
GJIROKASTER	328,600	52,850	120,000	36,000	0	0	537,450
HAS	65,020	10,870	16,000	0	0	0	91,890
KOLONJE	116,260	18,600	20,000	0	0	0	154,860
KORCE	639,200	105,250	295,000	85,000	0	0	1,124,450
KRUJE	178,320	29,280	32,000	0	0	0	239,600
KUKES	377,700	62,200	136,000	37,000	0	0	612,900
KURBIN	130,850	21,480	37,000	0	0	0	189,330
LEZHE	405,400	65,240	190,000	65,000	0	0	725,640
LIBRAZHD	214,100	34,960	54,000	0	0	0	303,060
LUSHNJE	328,450	53,830	107,000	48,000	0	0	537,280
M.MADHE	37,000	6,030	6,600	0	0	0	49,630
MALLAKASTER	59,300	9,770	13,000	0	0	0	82,070
MAT	187,100	30,640	40,000	0	0	0	257,740
MIRDITE	143,450	23,200	30,000	0	0	0	196,650
PEQIN	52,100	8,590	7,500	0	0	0	68,190
PERMET	112,950	18,350	35,000	0	0	0	166,300
POGRADEC	251,650	41,000	84,000	0	0	0	376,650
PUKE	143,350	23,300	40,000	0	0	0	206,650
SARANDE	233,150	38,100	120,000	35,000	0	0	426,250
SKRAPAR	112,100	18,410	18,000	0	0	0	148,510
SHKODER	830,500	136,880	396,650	70,000	0	0	1,434,030
TEPELENE	112,300	17,760	16,000	0	0	0	146,060
QSU "NENE TEREZA"	3,726,200	605,990	4,996,845	850,000	0	0	10,179,035
SUOGJ "MBRETERESHA GERALDINE"	438,200	71,000	300,000	33,000	0	0	842,200
SUOGJ "KOCO GLIOZHENI"	347,500	55,190	300,000	34,000	0	0	736,690
QSR "SHEFQET NDROQI"	753,700	122,000	918,700	70,000	0	0	1,864,400
TRAUMA	190,800	30,200	350,000	60,000	0	0	631,000
TROPOJE	147,560	24,270	40,000	0	0	0	211,830
VLORE	590,450	96,080	376,750	75,000	0	0	1,138,280
"MEMORIAL" FIER	0	0	0	0	780,000	0	780,000
DURRËS	0	0	0	80,000	1,480,000	0	1,560,000
Paketat e shërbimeve jopublik	0	0	0	0	1,641,765	0	1,641,765
Transferta për individët (mjekë specialistë)	0	0	0	0	15,000	0	15,000
Trajtime me VKM	0	0	0	0	20,000	0	20,000
Pagesat e shërbimeve PPP	0	0	0	0	2,860,000	0	2,860,000
rezerve	0	0	0	0	0	101,100	101,100
TOTALI	13,840,390	2,255,690	10,003,045	1,900,000	6,796,765	101,100	34,896,990



VENDIM
Nr. 503, datë 10.9.2025

PËR TRANSFERIMIN TE
KORPORATA E INVESTIMEVE
SHQIPTARE TË PRONAVE
SHTETËRORE PËR REALIZIMIN E
PROJEKTIT TË INVESTIMIT
“RIVITALIZIMI I PALLATIT TË
KONGRESEVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 71/2019, “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”, dhe në zbatim të shkronjës “b”, të pikës 1, të kreut II, të vendimit nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfitozë, *leasing*, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të shoqërisë aksionare “Korporata e Investimeve Shqiptare”, me NIPT: M01917011D, të pronave shtetërore, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi, për realizimin e projektit të investimit “Rivitalizimi i Pallatit të Kongreseve”.

2. Autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare për marrjen e masave me qëllim rivitalizimin e godinës së Pallatit të Kongreseve si dhe zhvillimin e pronës sipas shtojcës nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi, në funksion të miradministrimit të godinës së Pallatit të Kongreseve dhe të realizimit të projektit të investimit.

3. Korporata e Investimeve Shqiptare, vetë apo nëpërmjet entiteteve të krijuara prej saj, të zhvillojë pronat e përcaktuara në shtojcat nr. 1 dhe nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi, në funksion të realizimit të projektit të investimit, i cili ka si qëllim, ndër të tjera, përmbushjen e interesit publik.

4. Autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare dhe institucionet e përcaktuara në shtojcën nr. 3, bashkëlidhur këtij vendimi, apo

Faqe | 21382

autoritetet e autorizuar prej tyre, që, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të lidhin marrëveshje bashkëpunimi për përcaktimin e standardit, metodologjisë, termave dhe kushteve të bashkëpunimit për përmbushjen e interesit publik dhe të interesit të Korporatës, entiteteve në pronësi apo përgjegjësi administrimi të të cilit/cilave regjistrohet prona e re shtetërore, që zhvillohet si rezultat i përmbushjes së kushtit të transferimit të pronës/ autorizimit për zhvillim apo përmbushje të interesit të Korporatës, kushteve e nevojave për dorëzimin e pronës së re.

5. Autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare për kryerjen e procedurave përkatëse, sipas rregullave të përcaktuara në vendimin nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfitozë, *leasing*, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare”, të ndryshuar, për zhvillimin e pronave të përcaktuara në shtojcat nr. 1 dhe nr. 2, nëpërmjet instrumentit ligjor të sipërmarrjes, në përputhje me konceptidenë arkitekturore që do të dalë fituese nga konkursi ndërkombëtar.

Autorizohet Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore dhe Instituti i Ndërtimit që, në të njëjtën procedurë, të asistojë Korporatën e Investimeve Shqiptare nëpërmjet hartimit të termave të referencës të rivitalizimit të Pallatit të Kongreseve, objekt monument kulture i kategorisë II.

Autorizohet Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, që, në të njëjtën procedurë, të asistojë Korporatën e Investimeve Shqiptare, nëpërmjet hartimit të termave të referencës për projektidetë arkitekturore, hartimin e kriterëve të kualifikimit për projektuesit dhe kriterëve të vlerësimit paraprak e përfundimtar të projekteve arkitekturore.

Shpenzimet për shërbimet e parashikuara në këtë pikë mbulohen nga buxheti i Korporatës së Investimeve Shqiptare.

6. Autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare për negociimin me subjekte private dhe publike me qëllim lidhjen e kontratës përkatëse për zhvillimin e pronave të transferuara në pronësi apo për të cilat ka autorizim zhvillimi, në funksion të realizimit të projektit të investimit, bazuar në vendimin nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të



Ministrave, të ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre.

7. Autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare, vetë apo nëpërmjet subjekteve të krijuara prej saj, të kryejë veprimet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, institucionet publike kompetente për planifikimin e zhvillimin e territorit, apo me institucione të tjera, në kuadër të realizimit të projektit të investimit si dhe të sigurojë regjistrimin, në emër të Republikës së Shqipërisë dhe Korporatës së Investimeve Shqiptare, sipas parashikimeve të marrëveshjes së bashkëpunimit, të pronës së re shtetërore që do të krijohet në kuadër të projekteve të investimit.

8. Në funksion të zhvillimit të pronave të përcaktuara në këtë vendim, në përputhje me parashikimet ligjore përkatëse për ruajtjen e trashëgimisë kulturore si dhe planifikimin e zhvillimin e territorit, autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare për të proceduar me rivitalizimin e objekteve, pjesë e pronave të përcaktuara në shtojcën nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe në zbatim të pikës 5, të kreut II, të

vendimit nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfitozë, *leasing*, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare”, të ndryshuar, ngarkohet Korporata të kryejë procesin e konsolidimit të pronave të përcaktuara në shtojcat nr. 1 dhe nr. 2 në rast se konstatohet mospërputhje midis gjendjes faktike dhe ligjore të pronës.

9. Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, Instituti i Ndërtimit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Korporata e Investimeve Shqiptare për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA NR. 1 PRONAT QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË KORPORATËS

Nr.	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. e pasurisë (m ²)	Nga sip.		Institucioni me pronësi / përgjegjësi administrimi
				Truall (m ²)	Ndërtesë (m ²)	
1	8160	7/74	2261	2261	-	Republika e Shqipërisë/ MEKI VKM 437, datë 31.7.2025 “Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Bashkia Tiranë tek Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, të pasurisë me numër 7/74, në zonën kadastrale 8160, Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 834, datë 13.12.2006, të Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar
2	8160	7/88	2499	2499	-	Shtet

SHTOJCA NR. 2 PRONAT ME FUNKSION PUBLIK PËR TË CILAT KORPORATA VEPRON SI ZHVILLUES

Nr.	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. e pasurisë (m ²)	Nga sip.		Institucioni me pronësi / përgjegjësi administrimi
				Truall (m ²)	Ndërtesë (m ²)	
1	8160	7/89	11740	11740	5604.8	Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare VKM 1058, datë 16.7.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore,



						të cilat kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministrave, për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare”, të ndryshuar.
--	--	--	--	--	--	--

SHTOJCA NR. 3
INSTITUCIONI PUBLIK QË LIDH
MARRËVESHJEN E BASHKËPUNIMIT ME
KORPORATËN E INVESTIMEVE
SHQIPTARE

Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare

VENDIM
Nr. 504, datë 10.9.2025

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 531, DATË 7.9.2023, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E
SHOQËRISË AKSIONARE
SHTETËRORE ‘OPERATORI I
BLERJEVE TË PËRQENDRUARA’ SHA,
PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË
VEÇANTA TË PROKURIMIT PUBLIK,
NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË
KRYEMINISTRISË, MINISTRIVE DHE
INSTITUCIONEVE TË VARËSISË”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 105 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, dhe të pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 531, datë 7.9.2023, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Titulli i vendimit ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sh.a., për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve të varësisë”.

b) Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:
Faqe | 21384

“5. “OBP” sh.a., është organ qendror blerës, misioni i të cilit konsiston në kryerjen e procedurave të përqendruara të prokurimeve për mallra, punë, shërbime, me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve të varësisë, me përjashtim të rasteve kur me vendim të Këshillit të Ministrave është përcaktuar ndryshe.”.

c) Pika 11 shfuqizohet.

ç) Pika 11/1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“11/1. Bëjnë përjashtim nga parashikimet e pikës 5 të këtij vendimi institucionet, që realizojnë vetë procedurat e prokurimit publik, sipas legjislacionit në fuqi, si më poshtë vijon:

a) Shtypshkronjat e letrave me vlerë;

b) Shërbimi Informativ i Shtetit.”.

d) Pika 12 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“12. Vullnetarisht, me kërkesë të autoriteteve/ nteve kontraktore, “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sh.a., mund të pranojë dhe të zhvillojë procedura prokurimi në fushën e mbrojtjes e të sigurisë, në përputhje me nevojat specifike të autoritetit/entit përfutues, si dhe procedura prokurimi për institucione të tjera publike dhe jopublike, të cilat nuk janë subjekte të këtij vendimi.”.

dh) Pika 12/2 shfuqizohet.

2. Çdo procedurë, që nuk është shpallur në sistemin e prokurimit elektronik deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, dërgohet për t’u zhvilluar pranë “Operatorit të Blerjeve të Përqendruara” sh.a.

3. Vendimi nr. 603, datë 13.10.2021, i Këshillit të Ministrave, “Për ngarkimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të spitaleve publike, për disa mallra”, shfuqizohet.

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sh.a., dhe institucionet shtetërore/ ntet publike për zbatimin e këtij vendimi.



Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 505, datë 10.9.2025

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 425, DATË 27.5.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES SË SUBJEKTEVE TË PAJISURA ME LICENCË PËR PROJEKTIM, ZBATIM, MBIKËQYRJË DHE KOLAUDIM NË PASURITË KULTURORE, PËR KRYERJEN E INVESTIMEVE ME FONDE PUBLIKE NË PASURITË KULTURORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 90, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 22, e kreut II, të vendimit nr. 425, datë 27.5.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“22. Oferta fituese përcaktohet sipas çmimit më të ulët ose sipas konceptit “oferta më e favorshme”, duke u bazuar në kombinimin e elementeve teknike dhe ekonomike. Për vlerësimin e propozimeve teknike dhe ekonomike përdoren kriteret dhe metoda të përcaktuara në dokumentet standarde të konkurrimit publik.”

2. Ngarkohen ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, institucionet e specializuara në fushën e trashëgimisë kulturore, si dhe institucionet publike që kanë në administrim pasuri kulturore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

UDHËZIM
Nr.1, datë 10.9.2025

PËR MIRATIMIN E KOSTOS MESATARE TË NDËRTIMIT TË BANESAVE NGA ENTI KOMBËTAR I BANESAVE, PËR VITIN 2025

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “dh”, të nenit 72, të ligjit nr.22/2018, “Për strehimin social”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

1. Kostoja mesatare e ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, në shkallë republike, për vitin 2025, të jetë 56 491 (pesëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e një) lekë/m² për sipërfaqe shfrytëzimi.

2. Kostoja mesatare e ndërtimit sipas qyteteve, për vitin 2025, të jetë sipas tabelës nr.1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

3. Për qytetet, për të cilat nuk janë nxjerrë vlerat e koston mesatare të ndërtimit, merren vlerat e koston së ndërtimit të qytetit më të afërt, sipas tabelës nr.1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

4. Në rastet kur ka ndryshime të çmimit të zërave, mbi bazën e të cilave llogaritet kostoja mesatare e ndërtimit në manualin e integruar të çmimeve të ndërtimit, kostoja e ndërtimit, sipas manualit të integruar të çmimeve, e gjeneruar nëpërmjet portalit qeveritar “e-Albania”, prevalon mbi koston mesatare të ndërtimit të përcaktuar në këtë udhëzim.

5. Ngarkohen Ministria Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Enti Kombëtar i Banesave dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



Tabela nr.1

Kostoja mesatare e ndërtimit

Në koston mesatare nuk janë përfshirë vlerat e:

1. rrjetit inxhinierik;
2. projektit;

3. studimit gjeologjik e sizmik;
4. lejes së ndërtimit;
5. truallit;
6. shpenzime operacionale të EKB-së;
7. shpenzime të tjera.

NR	QYTETI	Kosto mesatare ndërtimi	
		Sip. Shfrytëzimi lekë/m2	Sip. Ndërtimi lekë/m2
1	ELBASAN	55,929	47,613
2	GRAMSH	55,929	47,613
3	LIBRAZHID	56,451	48,057
4	PËRRENJAS	56,451	48,057
5	PEQIN	55,929	47,613
6	POGRADEC	56,268	47,902
7	KORÇË	56,268	47,902
8	ERSEKË	56,398	48,012
9	TIRANË	55,535	47,277
10	DURRËS	55,654	47,378
11	KAVAJË	55,654	47,378
12	LUSHNJË	54,112	46,075
13	FIER	54,112	46,075
14	VLORE	56,757	48,318
15	BERAT	57,283	48,767
16	KUÇOVË	57,283	48,767
17	ÇOROVODË	57,283	48,767
18	PËRMET	57,624	49,055
19	TEPELENË	57,624	49,055
20	GJIROKASTËR	57,624	49,055
21	SARANDE	57,857	49,253
22	KRUJË	55,743	47,454
23	LAÇ	55,678	47,399
24	LEZHË	55,678	47,399
25	RRËSHEN	55,932	47,615
26	SHKODËR	56,726	48,291
27	PUKË	57,334	48,808
28	KUKËS	57,745	49,157
29	TROPOJË	57,745	49,157
30	BURREL	57,312	48,789
31	PESHKOPI	57,312	48,789
	KOSTOJA MESATARE	56,491	48,092

URDHËR

Nr. 173, datë 12.9.2025

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”; ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, si dhe Rregullores së

Brendshme të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, miratuar me urdhrin e Komisionerit nr. 46, datë 16.2.2024 , i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave për nënshkrimin e akteve administrative me karakter të përgjith-



hëm në kompetencë të titullarit/ omisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas legjislacionit të zbatueshëm dhe Rregullores së institucionit tek znj. Blerta Nerguti, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, duke filluar nga data 15.9.2025 deri më datë 19.9.2025.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtorët e Përgjithshëm pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për zbatimin e këtij urdhri.

3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E
INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE
Besnik Dervishi

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 224 lekë

